



# shqiptari i italisë

*l'albanese d'italia*

**CALL YOUR COUNTRY**

FOL ME VENDIN TËND  
DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.



BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543



## HIJET e VENERËS

Nga 29 marsi deri më 31 maj, në galerinë Pivarte të Bolonjës, një ekspozitë personale gjithëpërfshirëse e artistes shqiptare me banim në Milano Venera Kastrati. "Gruaja prodhon njeriun, njeriu do ta vrasë" Njeriu apo burri? Loja në anglisht e titullit është vetëm një nga dy-(a më shumë)-kuptueshmëria e veprave të artistes shqiptare



### LA QUARTA PARETE Kompania e parë teatrale shqiptare në Itali

Albert Dedja dhe Dardana Bërdyna vërte në skenë shtaqjen e tyre të parë, romanin e Omela Vorpsit "La mano che non mordi"



### ALI PODRIMJA "Poeti në të vranë të tij"

Parathënia e Visar Zhitit në botimin italisht të "Deserto Invasivo", përmbledhja me poezi e poetit të shquar kosovar



### KALEIDOSKOPI i shoqatave shqiptare

Një analizë kritike e realitetit të shoqatave shqiptare, rezultat i një pune disavjeça të ish-konsullit Hasan Muçostepa



**WESTERN UNION**  
MONEY TRANSFER


**TË JETOSH I QETË NË ITALI**  
për të mësuar gjithçka  
mbi të drejtat e tua **166.105.612**



# HIJET E VENERËS

Nga 29 marsi deri më 31 maj, në galerinë Pivarte të Bolonjës, një ekspozitë personale gjithëpërshirëse e artistes shqiptare me banim në Milano Venera Kastrati. “Gruaja prodhon njeriun, njeriu do ta vrasë” Njeriu apo burri? Loja në anglisht e titullit është vetëm një nga dy-(a më shumë)-kuptueshmëria e veprave të artistes shqiptare e cila përdor të gjitha mjetet e shprehjes figurative, nga grafika te videoinstalacioni.

**Art bashkëkohor do të thotë të tronditësh atë që sodit veprën - thuhet përgjithësisht për epokën e tanishme, vdekjen e pikturës, skulpturës dhe ringjalljen e tyre në përmasa psikedelike. Është kjo që perceptohet nëpër veprat e galerisë bolonjeze PivArte ku deri në ditët e fundit të majit po ekspozohen punimet e artistes shqiptare Venera Kastrati. "The woman produces the man, the man will kill her". Është një meditim kjo ekspozitë, e thellë, ironike, e tmerruese, një pikëpyetje për dhunën potenciale të natyrës njerëzore, dhe ekuilibrin e mbrapshtë midis erosit e thanatosit. Është e kaluara ballkanase ajo që ngjiz instinktivisht punimet e Kastratit, por**



**VENERA KASTRATI**

**"The woman produces the man.  
The man will kill her"**

**PivArte, Via Azzo Gardino, 8 - 40122 Bologna**

**29 mars - 31 maj 2008**

**edhe një refleksion universal-ist i dikujt që shfleton një manual të mërzitshëm historie botërore. Përcjell një tronditje, përjasja e objekteve dhe ngjyrave, ndjesive shkaktuese të përkundërta, që pikërisht për këtë natyrë me kahe të kundërta zbërthejnë absurditetin e asaj që na rrethon, e dhunës potenciale. Por Kastriati, me një listë të gjatë ekspozitash, është shumë më tepër se kaq. Është një artiste e ndjeshme që kujton të kaluarën e saj shqiptare, vitet e homologimit komunist ku të gjithë njerëzit ishin cerebralisht të njëjtë, vitet e këpucëve të njëllota që zënë shumë**

**hapësirë në krijimtarinë e saj. Është edhe një vëzhguese e llinjës së parë të asaj që shumëkush në Shqipëri ka përjetuar e perceptuar; ndarjen, izolimin, familjet e këputura nga një mur, mungesat dhe fosilizimi i marrëdhënieve të këputura në një shirit magnetofoni si ato të përshëndetjes së parë dhe të fundit në të largëtat vite '70 midis familjarëve të saj në Shqipëri dhe atyre në Kosovë. Ka një ndërthurje elementesh, idesh, ndjesish që i bëjnë punimet të mos shterin kuptimin e tyre çdo herë që shikimi kalon në to.**

## intervista

*Shqiptari i Italisë: Përse një titull kaq profetik, dhe drastik, çfare perkufizon ekspozita juaj aktuale?*

Venera Kastriati: "The woman produces the man. The man will kill her.", që e perkthyer ne shqip është "Gruaja prodhoi burrin/njeriun. Burri/njeriu do t'a vraste ate." është titulli i ekspozites personale që hapa ne 29 mars dhe do qendroj e hapur deri ne 31 maj ne galerine PivArte te Bolognes. Pike nisja e projektit ishte pikerisht roli i gruas, burimi prodhues i jetes, dhe responsabiliteti i saj. Si ajo ndikon ne formimin e njeriut, e nga kjo varet mireqenia apo katastrofa e asaj vete. Titulli eshte fillimi dhe parashikimi i nje fundi gati apokaliptik. Qellimi im ishte te realizoja me kete ekspozite nje ambient ku zhvilloheshin me shume pyetje e dyshime sesa pergjigje. Nje reflektim instiktiv e razional ne te



vijon nga faqja 9

njejten kohe.

Kisha vizatuar para syve te mi kete figure te gruas te krahasuar me nje makine prodhuese mekanike, jo responsabel per ate qe po krijon e ne fund krijesat e saj i kthehen kunder vetvetes. Me gruan kam personifikuar ambientin social e kultural nga ku shoqeria jone rritet e formohet. Pikerisht mes ketyre reflektimeve lind kerkimi im drejt Objekteve/Lodra, elementi simbolik i krijimit te fasave te para te identitetit te njeriut.

Ne instalacionin e vizatimeve te ekspozuara ne nje atmosfere gjysem te erresuar, intencioni im ishte pra te perceptohej ky kerkim kundrejt lodrave ne te gjitha kohet e momentet historike te njeriut. Nje thenie e Andy Wharol qe me pelqen eshte "Nuk eshte vete jeta qe ndryshon, ne te njejten menyre qe perseritet?". Mesazhi i Objektit/Loder i ka rezistuar koherave, ka ndryshuar vetem kostumet e teknologjite : kohet ndryshojne, por jeta perseritet.

*Keshtu, shoqerite komerciale me te medhaja qe merren me prodhimin e lodrave nuk shqetesohen per t'i ofruar femijeve nje bote qe t'a ndertojne e krijojne, por u ofrojne atyre nje bote te gatshme per t'u perdorur?*

Pikerisht keto prodhime/lodra qe lindin nga nje qellim i forte fitimi e biznesi gjithesesi jane nje realizim i kerkesave te klienteve, dmth te adulteve. E ne figuren e adultit, mbi te gjitha kam parasysh figuren e adultit krijues. Ne zemer te ekspozites mendova te varja nje panel plexiglasi transparent ku eshte stampuar figura e nje gruaje/loder qe ne vend qe te krijoje qenie humane, krijon figura lodrash te ushtarakeve te vegjel. Vizitoret bejne pjese integruese te installazionit qe nepermjet burimit te nje drite, pervec hijes se vizatimit te stampuar mbi plexiglas shkarkojne mbi mur edhe hijet e tyre. Cdokush prej nesh eshte bir/bije i nje nene, e cdokush prej nesh eshte responsabel per ate qe krijon, te ardhmen, te nesermen.

Ju keni realizuar një seri vizatimesh të ndarë në dy kategori, lodra femerore e mashkullore.

*Ju keni realizuar një seri vizatimesh të ndarë në dy kategori, lodra femerore e mashkullore.*

Po, kam bërë gati një ndarje gati raciale me lodrave. Ndersa ne lodrat femerore nje nga elementet eshte sensualiteti i tepruar jo femijeror qe kukullat ne komercialitet ofrojne , ne ato mashkulloret kam marre ne analize lodra te dhunshme, qe shtyjne djemte/femije ne fillim te ndertojne luftrat e tyre imagjinare ne



pritje per te realizuar ndoshta lojra reale katastrofike. Lodra qe mund te kthehen kunder asaj/atij qe i ka ofruar keto lodra, kunder shoqerise vete qe i krijoi, kunder gruas makine prodhuese qe krijoi burrin.

Ne serine e vizatimeve dedikuar influences se koltivimit te ndjenjave raciste, "White doll" nje kukull ku ne fillim del ne komercialitet ne ngjyre te zeze, e refuzuar nga klientet, shnderrohet nga e njejta shoqeri komerciale ne kukull te bardhe per t'iu adoptuar keshtu kerkesave te publikut.

Ne ekspozite nje rendesi te veçante kam dashur ti dedikoj videos "Harvest Moon" "Hena e korrjes". Video shume afer thenies "C'fare mbjell korr" dhe e pasur me nje seri simbolesh. Nje figure prodhuese qe koltivon

**Këtu dhe në faqet e tjera punime të artistes Venera Kastrati në ekspozitën e saj personale "The woman produces the man. The man will kill her"**

“ Më shumë se ç'do të thotë të jesh artist shqiptar në Itali, do të nënvizojë që është e vështirë të jesh ARTIST në Itali. Artisti sot ka shumë punë dhe përgjegjësi, e sidomos shumë role.

te ardhmen por ajo qe korr eshte katastrofa e saj, pasi barera te keqija hedhin krye dhe e kurthezojne.

Dhe se fundi mund te flas per serine e tre fotografive qe ekspozohen ne te vetmin vend te ndriçuar, te realizuara me pare akoma shkrepjes se makines fotografike, nepermjet krijimit te scenografive te teatreve te vogla te hijeve dhe ku thenia "Dora qe perkund djepin, drejton boten" me duket kaq prane ketyre imazheve gjigante.

*Është ky një kalim drejt një koncepti më universalist të veprave tuaja?*

Je duke përmendur një argument interesant e shume te kerkuar nga une. Ashtu si regjisti e kritiku i kinemase François Truffaut thote "Un'idea del mondo è un'idea del cinema" ("Nje ide e botes eshte nje ide e kinemase") une mendoj nje ide e botes eshte nje ide e artistit. Kur ne idene e artistit, publiku i ardhur nga çdo kah i botes gjen elemente te mjaftueshme per te reflektuar, atehere mund te mendoj qe ideja e artistit ka mundur te jete universale. Do ndjeja se kam realizuar idene time pikerisht nese do mundja te arrija ne territorin e konceptit universal dhe mendoj se jam drejt kesaj fase kerkimi. Mendoj qe ideja universale lind me pare me njeriun e me pas me vepren. Shpesh ka te beje edhe me faktin qe fola edhe me siper, "shoqerite komerciale prodhojne nje artikull per t'i pelqyer keshtu publikut", ashtu si artisti mund te beje te njejten gje kur nderkohe mund te zgjedhe edhe nje rruge tjeter; t'i ofroje publikut ate qe eshte pjese e publikut, ku ky i fundit mund te reflektoje e ku rreth vepres hapen shume pyetje e dyshime. Ku ideja nuk edhe e perkufizuar por i lend vend kompletimit e imagjines.

*Si lindin punimet tuaja përgjithësisht? Si vjen ngacmimi?*

Nganjehere idete kane qene te depozituara me vite ne mendjen time, e duhej vetem te arrinte momenti i duhur per me ne fund t'u realizuar. Here te tjera nga eksperiencat e reja ose edhe nga nje emozion i vogel qe me fut ne konfuzion idesh e ndoshta prej saj dalin me shume se nje ide e vetme.

*Sa Shqipëri ka në to? Si është filtruar Shqipëria në perceptimet tuaja?*

Njezet vitet e para te jetes sime i kam kaluar ne Tirane, eshte e pamundur te mos kete Shqiperi ne to. Shqiperi per mua do te thote çdo gje qe ka te beje me eksperiencat e mia te kaluara personale (femijeria, familja, miqte, ambientet qe kam frekuentuar, kultura, ambienti social, edukimi i çdo lloji si ne

*vijon në faqen 12*

vijon nga faqja 11

nivelin njerezor edhe intelektual). Nga keto eksperiencia personale lind edhe takimi me perceptimin universal. Keshthu une mendoj qe Shqiperia filtrohet shpesh instiktivisht e pavetedije tek une, pasi ben nje pjese te rendesishme te individualitetit tim.

*Çfarë ishte Shqipëria e diktaturës, në sytë e një vajzë të vogël atëherë dhe të një artisteje tani?*

Nënkuptoq se mund t'i referohesh projektit tim te realizuar ne 2004-en, "Appuntamenti al buio" ("Takim ne errësire") e ne veçanti videos "Not choose not to be" ("Te mos zgjedhesh te mos ekzistosh"), ku e ekspozoja per here te pare ne nje ekspozite personale ne Fieren e Bolognes te kuruar nga nje nga kuratorët me me ze Harald Szeemann (qe fatkeqesisht nuk eshte me ne jete) ne eventin "Balkans a crossroad to the future". Nuk mund te harroj energjine qe ishte krijuar perreth atij projekti.

Kisha zgjedhur pikerisht diktaturen e pare nepermjet syte te nje femije te vogel, pasi ate qe mund te shprehin femijet nuk eshte asnjehere dramatike ne ekstrem. Naiviteti e lehtësia me te cilin shprehin edhe dhimbjen me te madhe i le gjithmone porta te hapura reflektimit



dhe diskutimit. Duke e pare sot, me nje kendveshtrim tjetër me te pjekur si artiste, Shqiperia e diktatures per mua eshte trashegimi aktual i veshtiresive sociale dhe kulturele bashkangjitur kjo edhe veshtiresive ekonomike. Rezultatit e saj si nje flash back e lexoj mbi te gjitha ne syte e shuajtur te gjenerates se prinderve tane. Keqardhja mbi vite qe nuk mund te kthehen me kurre. Liria e levizjes pertej kufinjve akoma problematike sot. Tensionet dhe frika per te perballuar te nesermen, por me kete te fundit i afrohem edhe nje here asaj qe

Në lodrat mashkulloret kam marre ne analize lodra te dhunshme, qe shtyjne djemte/femije ne fillim te ndertojne luftrat e tyre imagjinare ne prite per te realizuar ndoshta lojra reale katastrofike. Lodra qe mund te kthehen kunder asaj/atij qe i ka ofruar keto lodra, kunder shoqerise vete qe i krijoi, kunder gruas makine prodhuese qe krijoi burrin

quhej universale.

*Po tani cilat jane marredheniet tuaja me Shqiperine, si perthyhet imazhi i saj brenda jush?*

Krenaria dhe lumturia ime arrin majat kur nepermjet meje mund te jap nje kontribut vendit tim te origjines, e mund te bej te degjohet emri i Shqiperise ne menyre pozitive ne bote. Pasi te jetuarit shume shpesh si "i huaj" ne nje vend shume prane kufinjve shqiptare siç eshte Italia, ka krijuar tek une nje pune te jashtezakonshme e

**OFERTË PROMOVIMI FANTASTIKE!**

EUROPE & USA      LATINA      ASIA      AFRICA      GLOBAL

# EDICARD

Si gjithnjë maksimumi i leverdisë dhe i cilësisë për telefonatat e tua

- **TARIFA KONKURRUESE DREJT ÇDO VENDI**
- **MINUTA NË DISPOZICION TË GARANTUARA**
- **MAKSIMUMI I CILËSISË NË BISEDË**

✓ nga telefoni i shtëpisë dhe celulari ✓ nga kabina telefonike ✓ customer care i posaçëm

**Vetëm pranë pikave të autorizuara SISAL**

www.eutelia.it  
www.sisal.it

**Shumë MINUTA më TEPËR**  
 për vendet kryesore duke përdorur, qoftë nga telefoni i shtëpisë qoftë nga celulari, numrat gjeografikë ose lokale

Esempli\*:

|                |     |
|----------------|-----|
| Moldova        | 120 |
| Romania        | 250 |
| Poland         | 750 |
| Ukraine        | 140 |
| Albania        | 190 |
| Georgia        | 220 |
| Russia Mosca   | 750 |
| Bulgaria Sofia | 450 |

**SISAL**  
il tuo centro  
SERVIZI

\* Shembuj minimalsh bisede në dispozicion me një PIN Edicard Europe & USA prej € 10 (përfaqësi i vo) duke përdorur, qoftë nga telefoni i shtëpisë qoftë nga celulari, numrat gjeografikë ose lokale. Detajet e ofertës dhe lista e numrave gjeografikë ose lokale në www.eutelia.it. Kostoja e telefonatës drejt numrit gjeografik ose lokal është në ngarkim të përdoruesit dhe faturohet nga operatori i tij telefonik sipas tarifave të parashikuara në kontratë.

te vazhdueshme per te thyer imazhin e gabuar persa i perket prototipit shqiptar qe eshte ndertuar nepermjet te gjitha burimeve qe shperndajne lajme mbi aktualitetin e flasin per kronikat e perditshme.

Shpesh krijohet nje imazh i gabuar i personit duke lexuar ne te, ne vend te individualitetit, personin e paragjykuar dhe te paravizualizuar, dhe kjo vlen per "te huajin" e ardhur nga USA ose nga Franca ose Shqiperia.

Sot Shqiperia me shume se kurre ka nevojte per lajme e aktualitete qe therrasin kundrejt nje imazhi te ri, e real qe gjithmone ka ekzistuar e ekziston, e krijon krenarine e nje kombi. Aktualitetet mbi artin, sportin, kinemane, arkitekturen, leteraturen... Mbi njerezit qe punojne shume e krijojne, qe mundohen te japin maksimumin e tyre per pasione e objektiva, e jam e sigurte qe si ne shqiperi dhe jashte saj jane shume emra per t'u permendur.

*Ne njefare menyre veprat tuaja jane nje interpretim aspektesh historike qe kane perfshire shume shqiptare, si jane pritur ato ne Itali?*

Mund te them qe me shume kuriozitet publiku i eshte afruar veprave te mia. Nje nga komplimentat me te bukura qe kam marre ka qene kur nga



publiku italian kam degjuar konsideracione te tilla, si psh; kur dikush eshte ndjere te behet pjese i historise sime te interpretuar ne projekt dhe te arrij deri aty sa t'a pervesoje ate, edhe pse ndonjehere tema lidhej ngushte me nje moment historik te caktuar shqiptar. Besimi dhe entuziasmi per te mbeshetur projektet e mia nga galeri te ndryshme ne Itali, si dhe mbeshtetja e madhe e kuratoreve si Harald Szeemann, artisteve qe me pasion e sakrificat i dedikohen krijimit atistik si Adrian Paci, miqve kudo ne bote dhe galerive

profesionale e me eksperience si Pianissimo, kane ndihmuar punen dhe kerkimet e mia, kane influencuar ne punen time dhe mbi te gjitha kane rritur besimin e kembenguljen tek vetvetja.

*Ç'do të thotë të jesh artist shqiptar në Itali?*

Mendoj që si çdo artist/e ne bote, eshte me fat nje artist/e qe mund te krijojte e te kete mundesi te jetoje me ate qe eshte pasioni i tij/i saj, te jetoje nepermjet asaj qe eshte duke realizuar endrrat e dëshirat e tij/te saj. Me shume se ç'do te thote te jesh artist shqiptar ne Itali, do te nenvizoja qe eshte e veshtire te jesh ARTIST ne Itali. Artisti sot ka shume pune dhe pergjegjesi, e sidomos shume role. Keshtu figura e artistit ne vetvete eshte shume komplekse. Sakrificat, pasioni, kembengulja e besimi tek vetvetja, jane keto elemetet themelor qe nuk duhet te lene asnjehere nese nuk do te humbesh artistin tek ty.

*Si e perkufizoni ne koordinata gjeografike identitetin tuaj artistik? Permasat e dyzuara midis Shqiperise dhe Kosoves, koncepti i kufirit prej pak hapash e megjithate hermetik) si*

*vijon në faqen 14*



**UNAR**  
Ufficio Nazionale Antidiscriminazioni Razziali



Presidenza del Consiglio dei Ministri  
Dipartimento per l'Uguaglianza e per il Dialogo



**SODALITAS**

**NÈ BASHKÈPUNIM ME**



**DIVERSITÀ AL LAVORO**

**PARAQESIN**




**PARTNERËT**




**Mundësi të barabarta për të gjithë në tregun e punës.  
Kërkojmë talente mes personave me pamundësi fizike ose të huaj.**

**[www.diversitallavoro.it](http://www.diversitallavoro.it)**

Job Meeting "Diversità al lavoro" të enjten më 15 maj 2008 nga ora 10 deri në 17 pranë ilSole24Ore, Rruga Monte Rosa, 91 Milano






















**INFORMACIONE: Sekretaria UNAR – Tel: 06.67792267 – e-mail: antidiscriminazioni@pariopportunita.gov.it**

vijon nga faqja 13

ndikojnë në këtë perceptim?

Me vjen nder mend projekti "7 Passi" (7 Hapat) e "Mirupafshim, Shadows of Voices", (Mirupafshim, Hije te Zerave) besoj qe pyetja i referohet ketyre projekteve....

Kur flisja per kujtesen, per eksperiencat personale, ja pra ky mur i lare ne lot e dhimbje midis Kosoves e Shqiperise eshte nje nga elementet qe ka lene shenja ne memorien time personale. Sigurisht mendoj qe ndarja e kufinjve nuk ka qene nje memorie e dhimbshme vetem personale, persa faktet tregojne qe kjo pjese e historise ka shenuar dhimbje ne shume zemra te ndara per vite, deri ne pamundesine per t'u pare serisht. Dhe jo vetem kaq, edhe ne memorien universale kjo çon ne murin e Berlinit dhe ndarjen e njeriut me njeriun jo vetem per shkaqe te nje muri real, por edhe te shkatuar nga faktoret ekonomike ose politike, si shume emigrante te prejardhur nga e gjithë bota e te shperngulur ne vende te ndryshme, perfshire keshtu edhe plagen e emigracionit italiane neper bote.

Familja ime me origjinë nga Kosova kishte bjellur tek une qe ne femijeri dashurine per nje vend per mua imagjinar e te pamundur. Ne punet e mia una kam dashur te nxjerr nga keto emozione qe i kam perjetuar personalisht pergjate viteve te jetuara ne Tirane, anen poetike dhe sentimentalismen qe mitizohet perballe pamundesise. Poezia qe gjeta ne kujtimet e babait tim qe ne periudhen e diktatures, qe ne fshehtesi ruante shamite e lagura me lot te halles/motres se tij qe ndodhej ne anen tjetër te murit/ndares ne Kosove (ne projektin "7 Passi"), dhe shiriti i pluhurezuar i magnetofonit te nje kujtimi te largët qe mbante te regjistruar zerat qe pershendesnin ne menyre formale njeri - tjetrin, si rezultat i nje takimi te pare e ndoshta te fundit te babait tim me te afermit e tij me te dashur pertej kufirit (ne Projektin



“

Krenaria dhe lumturia ime arin majat kur nëpërmjet meje mund t'i jap një kontribut vendit tim të origjinës, e mund të bëj të dëgjohet emri i Shqipërisë në mënyrë pozitive në botë. Pasi të jetuarit shumë shpesh si "i huaj" në një vend shumë pranë kufijve shqiptarë siç është Italia, ka krijuar tek unë një punë të jashtëzakonshme e të vazhdueshme për të thyer imazhin e gabuar përse i përket prototipit shqiptar që është ndërtuar nëpërmjet të gjitha burimeve që shpërndajnë lajme mbi aktualitetin e flasin për kronikat e përditshme

"Mirupafshim, Shadows of Voices") te gjitha keto ndjenja u kthyen tek une ne urgjence per komunikim, e nevoje per te shprehur nje nga emozionet me te forta e absurde te asaj periudhe.

*Si ka hyre arti ne jeten tuaj?*

Me natyralitet arti shkrihet me jeten e jeta ne artin. Jane dy elemente komplementare e te pandara. Krijimi ka lindur me njeriun, dhe ben pjese e natyres njerezore. Ndihem me fat te kem mundesi te ushtroj kete pa-

sion qe kultivoj qe nga femijeria edhe pse me sakrifica te njepasnjeshme. Te krijoj eshte nje ekzigjence per mua, ashtu si te marr fryme e te jetoj.

Po teknikat bashkekohore qe tashme jane mjeti juaj per excellence, si kane ardhur? Ndersa nga tradita klasike e shkolles shqiptare sa keni trasheguar?

Pervojat dhe eksperiencat e ndryshme gjate ketyre viteve, kane kultivuar tek une interesa ne teknika te ndryshme multimediale.

Hapat e formimit tim artistik si dhe interesat rreth artit filluan qe ne femijeri, me studimet e para 5 vjeçare per violine ne shkollen fillore muzikore ne Tirane, duke kaluar me pas ne liceun artistik Jordan Misja e se fundi me akademine e arteve te Tiranës, duke krijuar keshtu bazen e nje formimi klasik e natyrisht me mundesi teper te varfera informacioni per levizjet artistike bashkekohore ekzistuese jashte territorit shqiptar.

Me kalimin e kufirit ne '97 kerkimet e mia morren nje rruge interesante, permes te ciles po identifikohesha gjithmone e me shume. Duke permendur keshtu eksperiencat e para qe pata ne itali me nje kurs qe perfshinte teknikat e teatrit bashkekohor te hijeve, duke vazhduar me akademine e Breres ne Milano, studime

qe hapen tek une njohuri te reja si per shembull afrimin me videoartin e interesin tim perreth gjithçkaje qe kishte te bene mbi kinemane e heshtur e ate bashkekohore. Keto studime shtuan kuriozitetin rreth çdo forme arti, duke shtuar psh. njohjen me me detaj te fotografise, interesin per muziken duke i dhene fillim keshtu bashkepunitim tim me disa grupe muzikore. Shkembimi i eksperiencave me artiste nga vende te ndryshme te botes, urija per te shfletuar e njohur (si psh. kerkimet e mia qe vazhdojne me kuriozitet drejt psikanalizes, interesi per letteraturen) e sidomos nxitimi per te rekuperuar kohen ne dukje te humbur, vizitat e ekspozitave e muzeve, e se fundi udhetimet fatmiresisht te mundshme e jo te pakta, ne vende te ndryshme te botes, hapen mendjen time, e bene qe ne fillim te isha si nje forme kontenitori informacionesh kaotike. Pas kesaj fase filloi seleksionimi i ketyre eksperiencave per mua interesante e terheqese. Interesat e mia tashme permbledhin te gjitha teknikat si (teatrin e hijeve, videoartin, fotografine, vizatimet, objektet, e installazione ambientale).

Sot jam drejt kerkimit gjithmone e me esencial te asaj qe une quaj puna krijuese eksperimentale individuale.